



# QKLL 2025

AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

ALDA BARDHYLI – DREJTORE E QKLL

PËRGATITI: DR. ANILA VOGLI MAKRI

NËNTOR



## 12-16 NËNTOR 2025 / EDICIONI I 28-TË I PANAIRIT TË LIBRIT



Edicioni i 28 i Panairit të Librit hapi siparin në Pallatin e Kongreseve më datë 12 nëntor dhe vijoi deri më datë 16 nëntor ku priti në festën më të madhe të librit dashamirës, lexues, përkthyes, autorë dhe botues në stendat shumëngjyrëshe të librave.



Ky panair, i kthyer prej vitesh në pikëtakimin më të rëndësishëm letrar të vitit, ka sjellë takime frymëzuese me autorë shqiptarë e të huaj, prezantime librash të rinj, tituj të përkthyer nga letërsia botërore, diskutime letrare, nisma kulturore dhe aktivitete për të gjitha moshat. Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit – MTKS mbështet me përkushtim këtë traditë 28-vjeçare që promovon kulturën e librit, nxit leximin dhe fuqizon komunitetin letrar shqiptar.

### 3 NËNTOR 2025 / TAKIM ME AUTORIN ELVIN NURI RRETH VËLLIMI POETIK “KAOS ZHERMINAL”



### 5 NËNTOR 2025 / “IT’S MY TIME” NGA AUTORA FLORA SKENDO





# QKLL 2025

NËNTOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

## 12-16 NËNTOR 2025 / EDICIONI I 28-TË I PANAIRIT TË LIBRIT



Edicioni i 28 i Panairit të Librit hapi siparin në Pallatin e Kongreseve më datë 12 nëntor dhe vijoi deri më datë 16 nëntor ku priti në festën më të madhe të librit dashamirës, lexues, përkthyes, autorë dhe botues në stendat shumëngjyrëshe të librave.

Panairi më i madh kombëtar i librit, i cili mirëpret gjithë botën e librit në pesë ditë pati një program të ngjeshur me aktivitete dhe takime me autorë që sapo kanë botuar librat e tyre të rinj, por edhe takime të tjera për daljen e

disa titujve të përkthyer nga gjuhët botërore.

Panairi priti mijëra lexues, autorë, botues, përkthyes dhe dashamirës të librit në pesë ditë plot ngjyra, ide dhe zëra të rinj. Rreth 100 shtëpi botuese ishin pjesë e këtij panairi.





# QKLL 2025

NËNTOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT



Rreth 260 vepra u morën në shqyrtim nga juria për çmimet vjetore të Panairit të 28-të të Librit, një nga ngjarjet më të rëndësishme kulturore në vend, që bashkon botues, autorë dhe mijëra lexues. Juria e përbërë nga Maniela Sotaj, Teuta Dhima, Zija Vukaj, Beti Njuma dhe Elsa Skënderi vlerësuan autorët dhe përkthyesit më të spikatur të vitit.

*"Puna e jurisë u organizua në përputhje me disa parime formale, që lidheshin me kriteret e*

*pranimit të veprave apo të autorëve në konkurim. Në radhën e këtyre kriterëve, p.sh., ishte kriteri sipas të cilit një autor/përkthyes i vlerësuar me çmim Panairi brenda tri viteve të fundit nuk mund të klasifikohet si pretendent për çmim këtë vit",* tha Elsa Skënderi.

Çmimi "Autori më i mirë i vitit" i shkoi shkrimtarit dhe akademikut **Artan Fuga** për romanin "Ndëshkimi i dytë i Evës" (Papyrus), një vepër që ndërthur mitin biblik, dramën bashkëkohore

urbane dhe reflektimet mbi teknologjinë, duke u vlerësuar për dimensionin filozofik dhe psiko-social. Me çmimin "Përkthimi më i mirë" u vlerësua **Virgjil Muçi** për përkthimin mjeshtëror të romanit "Xhejmsi" të Percival Everett, vepër e shpallur fituese e Çmimit Pulitzer 2025. Përkthimi i tij u vlerësua për zhdërvjelltësinë gjuhësore dhe aftësinë për të ruajtur dy regjistrat e veçantë stilistikë të romanit origjinal.



# QKLL 2025

NËNTOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

**Urim Nerguti** mori çmimin “Përkthimi më i mirë nga frëngjishtja” për sjelljen në shqip të romanit “Hyrija” të Kamel Daoud, fitues i Çmimit Goncourt 2024. Nerguti u vlerësua për besnikërinë ndaj stilit karakteristik të autorit dhe për nuancat gjuhësore të përkthimit. Në kategoritë e tjera, **Ali Xhiku** u nderua me çmimin

“Autori i librit më të mirë studimor” për veprën “Faqeve të historiografisë shqiptare” (Onufri), një studim me rëndësi për teorinë dhe metodologjinë e historisë së letërsisë shqipe. Këtë vit, në ndryshim nga një vit më parë, u nda edhe çmimi “Autori i librit më të mirë për fëmijë”, i cili i shkoi **Valbona Bankës** për

romanin “Aria, në dorën time”. Krahas çmimeve u ndanë edhe dy diploma mirënjohjeje: një nga ambasada e Bullgarisë për përkthyesen **Janka Trifonova Selimi** dhe një tjetër nga ambasada e Polonisë për profesorin Arqile Teta.





# QKLL 2025

NËNTOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT



**Artan Fuga**  
Çmimi "Autori më i mirë i vitit"



**Virgil Muçi**  
Çmimi "Përkthimi më i mirë"

**Urim Nerguti**  
Çmimi "Përkthimi më i mirë nga frëngjishtja"





# QKLL 2025

NËNTOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT



**Ali Xhiku**

Çmimi "Autori i librit më të mirë studimor"



**Valbona Banka**  
Çmimi "Autori i librit më të mirë për fëmijë"



## DIPLOMA MIRËNJOHJEJE



**Janka Trifonova Selimi**



**Arqile Teta**





# QKLL 2025

NËNTOR




AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

## 3 NËNTOR 2025 / TAKIM ME AUTORIN ELVIN NURI RRETH VËLLIMI POETIK “KAOS ZHERMINAL”



Vëllimi poetik “Kaos Zherminal” nga Elvin Nuri, fitues i Çmimit të Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit për autorët e rinj, u prezantua në hapësirat e librari Valentinit, mes miqsh e njerëzve të kulturës. Një libër që del nga kaosi me zë të kthjellët, të sinqertë dhe emocional, si pulsi i brendshëm i qytetit. Vargjet e Elvin Nurit të ftojnë në një reflektim të thellë kulturor.





# QKLL 2025

NËNTOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

## 5 NËNTOR 2025 / "IT'S MY TIME" TAKIM ME AUTORIN FLORA SKENDO

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit promovoi librin "It's My Time" nga autorja Flora Skendo, një libër që nxit dialogun global për të drejtat dhe rolin e gruas në shoqëri. Autorja ndau mendimet e saj para një audience të gjerë në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit mbi ndikimin e këtij libri

dhe mënyrën se si ai mund të ndihmojë gratë të pranojnë vlerat e tyre dhe të ndërtojnë një realitet më të mirë për veten dhe shoqërinë. Ky libër është një manifest, që synon t'i japë gruas fuqinë për të marrë kontrollin mbi jetën e saj dhe për të krijuar një të ardhme më të bukur.

